



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Tergovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)

Bazuar në Udhëzimin Administrativ (MTI) nr. 01/2018, Vendimin nr. 5235 datë 15.07.2021 dhe Vendimin nr. 393/01 datë 09.06.2023 me qëllim të zvogëlimit të deficitit tregtar dhe përmirësimit të kapaciteteve prodhuese të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NVM), rritjen e investimeve, rritjes së eksportit, konkurrueshmërisë dhe hapjen e vendeve të reja të punës, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) shpallë:

Thirrje publike për përkrahjen financiare të NMVM-ve në sektorin e Industrisë Kreative (IK)

MINT/KIESA do të mbështes në subvencionim me mjete financiare ndërmarrjet mikro të vogla dhe të mesme. Të interesuarit për aplikim në këtë thirrje duhet të jenë qytetar të Republikës së Kosovës.

Shuma totale e skemës së grantit është 1,000,000.00 €.

Granti do të ndahet në tri kategori, si vijon:

Kategoria 1 – Ndërmarrjet mikro (të punësuar deri në 9 punëtorë)

Buxheti total për kategorinë e ndërmarrjeve mikro është 400,000.00 €

Kategoria 2 – Ndërmarrjet e vogla (të punësuar 10 deri në 49 punëtorë)

Buxheti total për kategorinë e ndërmarrjeve të vogla është 400,000.00 €

Kategoria 3 – Ndërmarrjet e mesme (të punësuar 50 deri në 249 punëtorë)

Buxheti total për kategorinë e ndërmarrjeve të mesme është 200,000.00€.

Në secilin rast Autoriteti Kontraktues (MINT/KIESA) rezervon të drejtën të mos shpërndajë të gjitha mjetet në dispozicion.

Për të gjitha procedurat e aplikimit dhe dokumentacionin e nevojshëm, MINT / KIESA ka përgatitur udhëzues për aplikant të cilët do t'i gjeni në linkun: <https://mint.rks-gov.net/> dhe <https://kiesa.rks-gov.net/> ndërsa për të aplikuar online kliko këtu: <https://rks-gov.net/670>

Thirrja për aplikim është e hapur nga data 04.08.2025 deri më datë 22.08.2025.